



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
NJËSIA E PROKURIMIT

Ballsh, më 04.07.2024

PROCESVERBAL

**PËR ARGUMENTIMIN E KRITEREVE PËR KUALIFIKIM
(KY PROCESVERBAL ËSHTË PËR EFEKT PUBLIKIMI BASHKË ME
DOKUMENTET E TENDERIT)**

(Prokurim që zhvillohet nga AK Bashkia Mallakastër, për nevoja të AK Ndërmarrja e Shërbimeve Publike)

Objekti i prokurimit:

“Blerje karburant (Diezel) viti 2024” për NSHP

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV):

09134100-8 Karburant diesel

Vlera e fondit limit:

15,990,000 (pesëmbëdhjetëmilion e nëntëqind e nëntëdhjetë mijë) **Lekë pa TVSH**

Bazuar në nenin 53, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 67, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kjo procedurë prokurimi zhvillohet nga AK Bashkia Mallakastër, për nevojat e AK Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Mallakastër.

Nënshkrimi i kontratës do të bëhet nga vetë AK Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Mallakastër.

Për fillimin e kësaj procedure, nga Titullari i Autoritetit Kontraktor ka dalë urdhëri përkatës i prokurimit, nëpërmjet të cilit është ngritur edhe Njësia e Prokurimit. Në vijim, është marrë konfirmimi nga Dega e Thesarit Mallakastër, si dhe nga Sekori i Financës në Bashki është marrë numri i transaksionit të kërkesë blerjes (urdhërit të prokurimit) të regjistruar dhe aprovuar paraprakisht në sistemin SIMF dhe SIFQ, sipas njoftimit të përbashkët të MFE dhe APP dhe Manualit Teknik “Integrimi i Sistemit të Prokurimit Elektronik me AFMIS”.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor (OQB) Bashkia Mallakastër ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VECANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesit duhet të paraqesin:

- a.** Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,
- b.** Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenet 26 dhe 30, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Ofertuesit duhet të paraqesin:

2.1. Për kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kjo pikë plotësohet me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76, 77 dhe 82, të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët Ekonomikë ofertues duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të tre viteve të fundit financiare (2021, 2022, 2023), lëshuar nga Administrata Tatimore, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në pikën 1, 2 dhe 3, të nenit 43, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e marzhit të xhiros së kërkuar në kufirin e përcaktuar më sipër, konsiderohet tregues i rëndësishëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes së kapaciteteve ekonomike dhe financiare të Operatorëve Ekonomikë ofertues, në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përveç bazës ligjore të sipërcituar, ky kriter është në përputhje edhe me legjislacionin e fushës, konkretisht, me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe në kërkesat e Ligjit Nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29, të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, përcaktohet se: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

2.2.2 Operatorët Ekonomikë ofertues duhet të paraqesin vërtetim/e për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga pushteti vendor për vitin 2023, lëshuar prej njësisive të vetëqeverisjes vendore ku Operatorët Ekonomikë ushtrojnë dhe kanë ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin/et e lëshuar nga njësia/të e vetëqeverisjes vendore përkatëse.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1/a dhe 2, e Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përveç bazës ligjore të sipërcituar, ky kriter mbështetet edhe në legjislacionin e fushës, konkretisht, në përcaktimet e bëra në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, dhe në nenet 2, 4 dhe 40, të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar. Nëpërmjet këtij kriteri synohet të vërtetohet që Operatori Ekonomik ofertues, e ushtron aktivitetin e tij në përputhje me kuadrin rregullator dhe duke përmbushur në mënyrë korrekte detyrimet që burojnë sipas legjislacionit të fushës, pasi të gjitha subjektet që ushtrojnë aktivitet tregtar kanë detyrim të regjistrohen pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, për të bërë të identifikueshme vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshkruar pagesës së taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga ky legjislacion.

2.3. Për kapacitetin teknik:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, Autoriteti Kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave/furnizimeve të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 6,000,000 (gjashtëmilion) Lekë pa TVSH dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti Kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:

- a. Vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku shënohen datat, shumat, zërat dhe sasi të mallrave të furnizuara ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat, zërat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në pikën 4, të nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të

zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën e kërkuar, vlerë e cila është më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.

Vlera e kërkuar për furnizimet e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj dhe shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor për të njohur gjendjen dhe kapacitetet e Operatorëve Ekonomikë ofertues, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Përvoja e mëparshme është një element i rëndësishëm që garanton Autoritetin Kontraktor, se Operatorët Ekonomikë mbi bazën e vlerës së furnizimeve të ngjashme zotërojnë kapacitetet e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Gjithashtu, gjykohet se përcaktimi i vlerës së përvojës së mëparshme në këtë nivel, jep mundësinë e aksesimit, pjesëmarrjes dhe ofertimit në këtë procedurë edhe të operatorëve ekonomikë të vegjël e të mesëm. Kjo kërkesë është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e objektit të prokurimit dhe njëkohësisht është brenda periudhës dhe vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2. Me qëllim reduktimin e shpenzimeve dhe kursimin e kohës për Autoritetin Kontraktor, Operatorët Ekonomikë ofertues duhet të kenë minimalisht një stacion furnizimi me karburant brenda territorit administrativ të Bashkisë Mallakastër, të vërtetuar me paraqitjen e dokumentacionit në njërën prej formave të disponimit sipas Kodit Civil (certifikatë për vërtetim pronësie shoqëruar me hartë treguese, me destinacion të përcaktuar si karburant ose kontratë huapërdorje/qiraje noteriale të vlefshme, shoqëruar detyrimisht me certifikatën për vërtetimin e pronësisë dhe hartën treguese, me destinacion të përcaktuar si karburant) dhe e regjistruar si pikë aktive për ushtrim aktiviteti në QKB. OE ofertues në dokumentacionin e pronësisë së karburantit kërkuar si më sipër, duhet të kenë shesh/sipërfaqe të mjaftueshme (për hyrjen, daljen dhe furnizimin normal të mjeteve), me qëllim aksesimi të lehtësishëm për furnizimin e mjeteve të rënda, mjeteve teknologjike dhe mjeteve që nuk qarkullojnë në rrugë dhe që duhet të furnizohen të ngarkuara në rimorkiator/transportier me tërheqës.

Argumentimi: *Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Ky kriter është vendosur për të evituar kosto të shtuara për Autoritetin Kontraktor në lidhje me procesin e furnizimit të automjeteve me karburant dhe për këtë arsye është kërkuar që stacioni i propozuar për shitjen e karburantit të jetë brenda territorit administrativ të Bashkisë Mallakastër, vërtetuar me dokumentacionin përkatës të kërkuar, dokumentacion i cili është në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe jep garancinë e nevojshme që aktiviteti ushtrohet në objekte të destinuara për tregtim karburantesh, duke kaluar të gjitha hallkat e miratimit për ushtrimin e një aktiviteti të tillë, gjithçka në funksion të zbatimit të kontratës. Nëpërmjet këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor synon të ulë koston e furnizimit të automjeteve, sipas parimit të ekonomisë së kursimit, për shkak se automjetet do të furnizohen në stacionin e karburantit dhe në rast se ky stacion do të ishte më larg, kjo do të ndikonte direkt në rritjen e koston, pasi mjetet do të harxhonin më tepër karburant për shkak të itinerarit që do të*

përshkojnë. Gjithashtu, nëpërmjet këtij kriteri, synohet edhe kursimi i kohës që do të duhet për të realizuar procesin e furnizimit në stacionin e karburantit, për shkak të numrit relativisht të madh dhe larmishmërisë së automjeteve të AK. Gjithashtu, është kërkuar që OE ofertues në dokumentacionin e pronësisë së karburantit, duhet të kenë gjithashtu edhe shesh/sipërfaqe të mjaftueshme (për hyrjen, daljen dhe furnizimin normal të mjeteve). Kjo kërkesë është vendosur me qëllim aksesimi të lehtësishëm për furnizimin e mjeteve të rënda, mjeteve teknologjike dhe mjeteve që nuk qarkullojnë në rrugë dhe që duhet të furnizohen të ngarkuara në rimorkiator/transportier me tërheqës.

2.3.3. Operatorët Ekonomikë ofertues duhet të jenë të pajisur dhe të paraqesin Licencë/Autorizim për tregtimin me pakicë të karburanteve/lëndëve djegëse (të vlefshëm) për stacionin e propozuar të shitjes së karburantit, lëshuar nga organet e vetëqeverisjes vendore sipas juridiksionit përkatës, në përputhje me dispozitat e Ligjit nr.8450, datë 24.02.1999 dhe VKM nr.970, datë 02.12.2015.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe në pikën 5/a, të nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përveç bazës ligjore të sipërcituar, ky kriter është në përputhje edhe me legjislacionin e fushës, konkretisht, me përcaktimet e bëra në dispozitat e Ligjit nr.8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre” i ndryshuar, si dhe në përcaktimet e VKM nr.970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”.

Me anë të këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor synon të krijojë bindjen dhe të marrë garancinë e nevojshme se Operatorët Ekonomikë ofertues, e ushtrojnë aktivitetin e tyre tregtar në përputhje me kushtet dhe rregullat e përcaktuara nga legjislacioni i fushës në fuqi, duke dëshmuar se disponojnë Licencën/Autorizimin përkatës për furnizimin e mallrave të kërkuara, në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.4. Operatorët Ekonomikë ofertues duhet të paraqesin një deklaratë me shkrim, nëpërmjet të cilës të garantojnë se marrin përsipër ofrimin e furnizimit me karburant për mjetet e transportit nëpërmjet kartave elektronike të personalizuar, ashtu siç përcaktohet VKM nr.561, datë 29.07.2016 “Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. Gjithashtu, të garantojnë dhe deklarojnë se marrin përsipër me koston e tyre, prodhimin dhe pajisjen e Autoritetit Kontraktor me karta elektronike të personalizuar.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”, si dhe në përcaktimet e bëra në VKM nr.561, datë 29.07.2016 “Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. Për këtë qëllim është kërkuar që të paraqitet një deklaratë e Operatorëve

Ekonomikë ofertues, të cilët duhet të ofrojnë furnizimin me karburant për mjetet e transportit nëpërmjet kartave elektronike të personalizuar, gjë e cila garanton Autoritetin Kontraktor për realizimin me sukses të kontratës, sipas kuadrit rregullator të përcaktuar në VKM nr.561, datë 29.07.2016 “Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. Nëpërmjet këtij kriteri synohet gjithashtu, edhe evitimi i kostove të shtuara për Autoritetin Kontraktor, sa i përket kostos së prodhimit dhe pajisjes me karta elektronike të personalizuar, në funksion të zbatimit të kontratës.

2.3.5. Operatorët Ekonomikë ofertues duhet të paraqesin një deklaratë me shkrim, nëpërmjet të cilës të garantojnë se marrin përsipër ofrimin e furnizimit me karburant 24 orë, çdo ditë të javës.

Argumentimi: *Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Nëpërmjet vendosjes së këtij kriteri, synohet që Operatorët Ekonomikë ofertues të dëshmojnë disponibilitetin e nevojshëm për furnizimin e pandërprerë me karburant nëpërmjet paraqitjes së deklaratës së kërkuar, gjë e cila garanton Autoritetin Kontraktor për realizimin me sukses të kontratës. Kjo për faktin, se Autoriteti Kontraktor disponon një kategori automjetesh shërbimi (makinat teknologjike për largimin e mbetjeve urbane, automjet zjarrëfikës, etj.), të cilat punojnë në orare të ndryshme apo edhe jashtë orarit zyrtar, për t’i paraprirë gjithashtu edhe rasteve apo situatave emergjente që mund të krijohen.*

2.3.6. Operatorët Ekonomikë ofertues duhet të paraqesin “Vërtetim që OE nuk ka masë administrative për respektimin e kërkesave të standardit teknik të naftës” lëshuar nga Inspektoriat Shtetëror Teknik Industrial (ISHTI) gjatë vitit 2024, si dhe “Raport Testimi” për artikullin Gazoil (Diezel), lëshuar gjatë vitit 2024, nga ISHTI ose nga një organizëm/subjekt kompetent i certifikuar/autorizuar/akredituar, me qëllim vërtetimin e pajtueshmërisë së artikullit të kërkuar me specifikimet teknike.

Argumentimi: *Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe pikën 6/c, të nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësinë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e Operatorëve Ekonomikë ofertues dhe shërben njëkohësisht si një garanci për Autoritetin Kontraktor, sa i përket cilësisë së karburantit. Pra, nëpërmjet këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor kërkon të garantohet që parametrat dhe karakteristikat teknike të mallit të ofertuar të përputhen me specifikimet teknike të kërkuara.

Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike janë hartuar duke u bazuar në parametrat e lejuara dhe sipas standardeve në fuqi, të cilat përmbushin kërkesat dhe nevojat e AK. Specifikimet teknike për artikullin e kërkuar karburant (dizel/gazoil), përshkruajnë tërësinë e elementëve më të rëndësishëm përbërës, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (neni 36), dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (neni 40 pika 2).

Specifikimet teknike janë lehtësisht të aksesueshme dhe gjenden në shtojcën përkatëse të setit të DST në skedarët e sistemit të prokurimit elektronik.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Përlllogaritja e fondit limit: Përlllogaritja e fondit limit, është realizuar me metodën e studimit të tregut sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (neni 13 dhe neni 76 pika 1/b).

Referuar përlllogaritjes së fondit limit, kostoja totale e preventivuar dhe e miratuar nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Mallakastër është 19,188,000 (nëntëmbëdhjetëmilion e njëqind e tetëdhjetë e tetëmijë) Lekë me TVSH ose **15,990,000** (pesëmbëdhjetëmilion e nëntëqind e nëntëdhjetë mijë) **Lekë pa TVSH.**

Gjithashtu, Komisioni ka përcaktuar edhe afatin e zbatimit të kontratës prej 12 (dymbëdhjetë) muaj / deri në ekzekutimin e plotë të vlerës që do të kontraktohet.

Dokumentacioni teknik i kësaj procedure prokurimi (specifikimet teknike, përlllogaritja e fondit limit dhe afati i lëvrimit), është përgatitur dhe miratuar nga strukturat përkatëse të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike sipas Aktit Teknik nr.94/1 regj, datë 12.06.2024. Më pas, ky dokumentacion është përcjellë pranë Bashkisë Mallakastër dhe është regjistruar në Zyrën e Protokollit me nr.2882 prot, datë 12.06.2024, për të filluar procedurën e prokurimit.

Bazuar në parashikimet e legjislacionit të prokurimit publik, por edhe në praktikat e aplikuara gjerësisht nga autoritetet kontraktore që prokurojnë fondet publike, si kriter vlerësimi përzgjidhet dhe përcaktohet: “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim”.

OE ofertues duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet e bëra në pikën 2.1, të nenit 45, të VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik, të ndryshuar, ku është përcaktuar:

“2.1. Për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, në rastet kur oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët, ky i fundit përllogaritet bazuar në:

a) çmimin e bursës, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim çdo javë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në Buletinin e Njoftimeve Publike;

b) elementet fiskale;

c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës”

OE ofertues së bashku me shtojcën nr.2, të dokumentave standarte të tenderit, duhet të paraqesin edhe strukturën e përllogaritjes së çmimit, ku të evidentohet norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute (Lekë) dhe elementët e tjerë përbërës. Mosparaqitja e strukturës së përllogaritjes së çmimit përbën kusht për skualifikim. Më poshtë jepet një model tabelar i strukturës së përllogaritjes së çmimit.

Emërtimi i elementëve përbërës të çmimit të diezelit/gazoilit	Çmimi \$/Ton	Kursi i këmbimit të \$ në datën e publikimit të bursës	Vlera Lekë/Ton	Vlera Lekë/Kg	Densiteti (Vlera mesatare për ofertim)	Vlera Lekë/Litër
Bursa						
Premio						
Çmimi i blerjes (Bursa + Premio)					0,8325	
Akciza						37
Taksë karboni						3
Taksë qarkullimi						27
Taksë markimi						0.614
Norma e fitimit në vlerë absolute						
Çmimi Lekë/Litër pa TVSH						
TVSH 20%						
Çmimi Lekë/Litër me TVSH						

OE ofertues mund të paraqesin modelet e veta tabelare, me kusht që të përmbajnë të gjithë elementët dhe vlerat e tyre.

Shënim: Duke qenë se densiteti i produktit është/mund të jetë variabël/i ndryshueshëm gjatë zbatimit të kontratës, dhe gjithmonë brenda kufirit të normave të lejuara (minimum 0,820 dhe maksimum 0,845), atëherë për efekt të parimit të barazisë në ofertim, densiteti të llogaritet sipas vlerës mesatare prej 0,835 të dhënë në tabelën e mësipërme.

Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute, do të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës.

NJËSIA E PROKURIMIT